



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA DIBËR
SEKTORI I PROKURIMEVE PUBLIKE

Data: 19.05.2025

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

**OBJEKTI I PROCEDURËS: Blerje materiale per lyrjen e objekteve arsimore dhe social
kulturore Bashkia Diber 2025**

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): Bojra
(44810000-1)

VLERA E FONDIT LIMIT: 1.249.853 (Nje milion e dyqind e dyzet e nentemije e teteqind e pesedhjete
e tre) **leke pa TVSH**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe
nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit
publik”, autoriteti/enti kontraktor BASHKIA DIBER ka hartuar procesverbalin për
argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën
e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9:*

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Kapaciteti profesional i operatorëve ekonomikë:

2.1.1 Sipas percaktimeve të bera në Shtojcën 7 të DST-ve (Kriteret e Përgjithshme të Përzgjedhjes/ Kualifikimit).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, të LPP, *ky kriter kerkohet sepse verteton se oporetet ekonomik kane kapacitetet e duhura ligjore per kryerjen e furnizimeve te mallrave*

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar gjatë viteve 2022,2023 dhe 2024 ku vlera mesatare e të tre viteve të jete jo me e vogel se 40 % e fondit limit, të vërtetuar me një dokument të lëshuar nga administrata tatimore.

Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:Ky kriter vendoset per te siguruar oporetet ekonomik kapacitetet financiare te duhura per permbushjen e kushteve te kontrates.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në neni nenin 43 pika 2 germa c , të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, ku citohet:

c) 40 % të vlerës së parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar.

2.2.2 Vërtetim për shlyerjen e taksave dhe tarifave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin **2024**, prane njesive vendore ku operatori ekonomik ushtron apo ka ushtruar aktivitetin, sipas ekstraktit të QKB, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës.

Shenim: Per kete pike 2.2.2 te mesiperme oporetet ekonomik ne fazen e ofertimit duhet te paraqesin formularin e vetedeklarimit sipas shtojces nr.8.

Ndërsa operatori ekonomik fitues duhet të dorëzojë pranë AK, “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike . Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin”.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, në ligjin nr.9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore” i ndryshuar, neni 3.1/a, b, c dhe neni 40, në ligjin nr.131/2015 “Për QKB” i ndryshuar, si dhe në ligjin nr.9723 datë 03.05.2007 “Për QKR” i ndryshuar.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës së fondit limit të kësaj kontrate.

Për të vertetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomik duhet të paraqesin dëshmitë si mëposhte:

2.3.1.a *Për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vertetime të leshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shenohet vlera, afati I përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore e shitjes të plotësuar sipas legjislacionit në fuqi, ku shenohet data, shuma, dhe sasitë e mallrave të furnizuara.*

Ose

2.3.1.b *Për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shenohet data dhe sasitë e mallrave të furnizuara.*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 40, pika 4, nenin 55, pika 4/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në

vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë: Ky kriter është përcaktuar dhe dhe vertetuar eksperiencën e mepareshme të operatorëve ekonomik.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë një certifikatë që vërteton cilësinë e menaxhimit të shoqërisë, sipas standardit ndërkombëtar **ISO 9001** (Sistemi i menaxhimit të cilësisë) (e vlefshme) **ose ekuivalente e saj**.

Çertifikata duhet të jetë në fuqi, e vlefshme në ditën e hapjes së procedurës dhe të jetë e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues të njohura nga Republika e Shqipërisë.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nënnt 79 , pika 1,të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ku citohet:

1)Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikatë të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar punonjës si mëposhte:

1 (një) Shofer , për këtë duhet të paraqesin kontratë pune të vlefshme,leje drejtimi mjeti të lëshuar nga organet kompetente,dhe të figurojë në muajin e fundit listë pagesën e shoqërisë

- Operatori ekonomik duhet të paraqesë listë pagesat e shoqërisë për periudhën të paktën muajin e fundit.

Kriteri për pikën 2.3.4 konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 8 të DT.

Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatëve të ankimit, ofertuesi i kualifikuar, i pari duhet të dorëzojë dokumentacionin provues të parashikuar në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike . Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin”.

Argumentim: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

Ky kriter kerkohet qe operatoret ekonomik te disponojne 1 shofer te siguruar duke u bazuar ne afatin e zbatimit te kontrates dhe zerat e preventivit, per permbushjen e kontrates ne menyre sa me te rregullt dhe me sukses sipas kerkesave te AK Bashkia Diber.

2.3.4 Ofertuesi duhet te kete ne pronesi ose ne perdorim kundrejt kontrates perkatese, mjete si me poshte:

Nr	Lloji i makinerive	Pronësia	Njësia	Sasia
1	Automjet me kapacitet mbajtes deri ne 3.5 ton	në pronesi ose me qera	copë	1

Per mjetet ne pronesi: Certificate pronesie, leje qarkullimi, taksat vjetore, kolaudim (kontrollin teknik) (te vlefshme) ,siguracion (police sigurimi) (te vlefshme) dhe licence per transportit te mallrave.

Per mjetet e marra me qera: Kontrate qeraje (te vlefshme) Certificate pronesie, leje qarkullimi, taksat vjetore, kolaudim (kontrolli teknik) (te vlefshme),siguracion (police sigurimi) (te vlefshme) dhe licence transportit te mallrave (te vlefshme).

Kriteri per piken 2.3.5 konsiderohet i permbushur me plotesimin e formularit sipas shtojcës 8 të DT.

Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ofertuesi i kualifikuar, i pari duhet te dorëzoje dokumentacionin provues të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike . Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin”.

Argumentim: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5/ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohej që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

Ky kriter kerkohet ne baze te afatitper zbatimin e kontrates dhe zerave te preventivit qe operatoret ekonomik te disponojne ne pronesi ose me qera 1 mjete, per transportimin e mallrave objekt kontrate, dhe te beje te mundur permbushjen e kontrates ne menyre sa me te rregullt dhe me sukses sipas kerkesave te AK Bashkia Diber.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.***

NJESIA E PROKURIMIT